

ASi përfaqësuese të zgjedhura respektivisht përfaqësues të zgjedhur në konferencën e shkollës ju vendosni së bashku mbi:

- ▶ Programin e shkollës.
- ▶ Përfundimin e marrëveshjeve mbi kooperimin e shkollës dhe bashkëpunimin me partnerë të tjerë.
- ▶ Krijimin e ofertave për përkujdesje dhe atyre për gjithë ditën.
- ▶ Vëllimin dhe shpërndarjen e detyrave të shtëpisë.
- ▶ Lëshimin ose ndryshimin e një rregulloreje të shkollës.
- ▶ Parimet për sjelljen me vështirësitë e përgjithshme të edukimit si dhe për përfundimet e marrëveshjeve për edukimin dhe arsimin.
- ▶ Futjen dhe sigurimin e aparateve dhe mjeteve mësimore.
- ▶ Vendimin e buxhetit të shkollës.
- ▶ Përcaktimin e ditëve të lëvizshme të pushimeve.
- ▶ Parimet dhe vëllimin e informacioneve për prindërit dhe këshillave për prindërit.

Përveç kësaj ka akoma edhe vendime të mëtejshme në konferencën e shkollës, në të cilën mund të marrin pjesë përfaqësuese të prindërve dhe përfaqësues të prindërve.

Se si merrni ju pjesë në zhvillimin e jetës së përditshme shkollë të fëmijëve tuaj dhe çfarë ndikimi mund të keni ju mbi përmbajtjen dhe ecurinë e mësimin, këtë e rregullon ligji i shkollës së Landit „Nordrhein Westfalen“.

Flisni ju me mësuesen kujdestare të klasës ose me mësuesin kujdestar të klasës së fëmijës suaj. Bashkëpunimi besimplotë dhe dialogu i hapur, respektplotë kontribuojnë për një mbarëvajtje me njëritjetrin dhe një bashkëpunim shkollor pozitiv.

Informacione të mëtejshme ju merrni në shkresat e informimit të Landit NRW të cilat ju mund t'i porosisni ose t'i gjeni në internet:
<https://broschueren.nordrheinwestfalendirekt.de>
Kërkim me fjalë: Elternmitwirkung in der Schule (Bashkëpunimi i prindërve në shkollë)

www.bildung-in-bielefeld.de

Stadtelternrat Bielefeld e.V. ©
www.stadtelternrat-bielefeld.de

Schulamt für die Stadt Bielefeld
Untere staatliche Schulaufsichtsbehörde
Niederwall 23, 33602 Bielefeld
www.bezreg-detmold.nrw.de

Herausgegeben von:
Stadt Bielefeld
Kommunales
Integrationszentrum

Neues Rathaus Niederwall 23, 33602 Bielefeld
www.ki-bielefeld.de

Verantwortlich für den Inhalt:
Nilgün Isfendiyar
Leiterin des Kommunalen Integrationszentrums

 **Kommunales
Integrationszentrum
Bielefeld**

Das Kommunale Integrationszentrum wird gefördert durch:

Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-
Westfalen



Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Stand: April 2020

**W
BI**

Stadt Bielefeld Elternmitwirkung in der Grundschule Albanisch

 www.bielefeld.de

**Bashkëpunimi i prindërve
në shkollë**




Të dashur prindër!

Shkolla është një vend, në të cilin demokracia jepet si mësim dhe praktikohet. Ne të gjithë, të cilët marrim pjesë në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve tanë, vendosim së bashku mbi jetën e përditshme pedagogjike në shkollë. Këtu bëni pjesë edhe ju si prindër.

Kujdestaria e klasës

Të gjithë prindërit e një klase zgjedhin në fillim të një vitishkollor, kujdestarinë e klasës, nga mezi i tyre një kryetare ose një kryetar si dhe një zëvendës ose një zëvendës.



E këshillueshme është, krahas zgjedhjes së një kryetareje / kryetari të kujdestarisë së klasës, një bashkërenditje e një ekipi prej prindërish, të cilët qëndrojnë në dispozicion si referente për prindërit e tjerë. Mësuesja kujdestare e klasës ose mësuesi kujdestar i klasës ka gjatë takimit për kujdestarinë e klasës një funksion këshillues dhe informues. Në përmbajtje trajtohen temat e mëposhtme:


- ▶ Propozime për futjen e mjeteve mësimore
- ▶ Rishqyrtime për përparime
- ▶ Detyrat e shtëpisë
- ▶ Aktivitetet shkollore / udhëtimet e klasës
- ▶ Pyetjet e edukimit

Kryetarja ose kryetari i zgjedhur i kujdestarisë së klasës së një klase sjell dëshirat dhe propozimet e prindërve në kujdestarinë e shkollës.

Në faqet vijuese ne ju japim juve një përmbledhje të shkurtër, mbi mundësitë e bashkëpunimit të prindërve në shkollën fillore tek ne në „Nordrhein-Westfalen“.

Kujdestaria e shkollës

Takimi i të gjithë kryetarëve të zgjedhur të kujdestarisë së klasave emërtohet kujdestari e shkollës. Në këtë mbledhje zgjidhet nga ana tjetër një kryetar e ose një kryetar si dhe zëvendës ose një zëvendës.



Kujdestaria e shkollës është një forum i përshtatshëm diskutimi, për të biseduar dhe për të bashkërenduar pikëpamjet dhe interesat e ndryshme të të gjithë prindërve. Drejtorja e shkollës mund të marrë pjesë në mbledhje si këshilluese dhe informuese.

Nëpërmjet të drejtorisë së shkollës mund të paraqiten dhe të këshillohen në kujdestarinë e shkollës vendime, të cilat duhet të merren në konferencën pasuese të shkollës. Vendime të kujdestarisë së shkollës mund të sillen si kërkesa vetjake në konferencën e shkollës.

Sipas numrit të përgjithshëm të nxënësve të një shkolle, kujdestaria e shkollës zgjedh nga mezi i saj përfaqësuese ose përfaqësues të mëtejshëm, të cilët marrin pjesë në konferencën e shkollës me kryetaren ose kryetarin e kujdestarisë së shkollës.

Konferenca e shkollës

Konferenca e shkollës është instanca më e lartë e bashkëpunimit të shkollës fillore. Ajo përbëhet nga përfaqësues dhe përfaqësues të prindërve dhe të forcave mësimore. Përfaqësuesit e prindërve zgjidhen nga kujdestaria e shkollës dhe përfaqësuesit e mësuesve nga konferenca e mësuesve dhe mësuesve.



Në konferencën e shkollës mund të merren vendime dhe të bëhen ndryshime të gjera dhe të gjithanshme.

Drejtoresha e shkollës ose drejtori i shkollës mban kryesinë në konferencën e shkollës. Ajo ose ai nuk kanë të drejtë vote. Vetëm në rast të barazisë së votave mendimi i drejtorisë së shkollës është vendimtar për një vendim.

Në faqen mbrapa ju gjeni një ërzgjedhje të temave të mundshme nga detyrat e përcaktuara saktësisht, në nenin 65 të ligjit të shkollës në „NRW“, për konferencën e shkollës.